

Pedagogjia Profesionale 180 CP në Shëndetësi

Fusha Profesionale Infermieri

Programi i studimeve bachelor "Pedagogjia profesionale në Shëndetësi" ju mundëson kandidatëve me kualifikim profesional shëndetësorë (Infermierorë) arritjen e gradës shkencore Bachelor dhe kualifikimin pedagogjik. Studentët aftësohen që në mënyrë të pavarur të organizojnë, realizojnë dhe menaxhojnë informimin, edukimin dhe këshillimin e pacientëve dhe procesin e mësimin shëndetësorë në institucionet shëndetësore dhe arsimore.

Fushat e angazhimit

Pas përfundimit të suksesshëm të programit të studimeve, kandidatët janë të përgatitur të angazhohen me sukses në këto hapësira profesionale brenda sistemit shëndetësorë dhe arsimor të Republikës së Kosovës, rajonit dhe Evropës:

- Informim - këshillim dhe edukim shëndetësorë të pacientëve
- Ofrim i pavarur i shërbimeve profesionale të kujdesit infermieror në nivelin primar, sekondar dhe terciar
- Angazhim në edukim në shkollat e përgjithshme dhe profesionale
- Evidence-based Nurses (Monitorim të studentëve, realizim të projekteve të vogla hulumtuese)
- Mbështetje në hulumtimin infermieror
- Ekspertizë profesionale për problemet infermiore
- Menagjim të rasteve/menagjim të kujdesit (Case Manager/Care Manager)
- Veprimtari këshillimore të temave infermiore (Sigurimi shëndetësor, udhëheqje të ambulancave infermiore)
- Udhëheqje të grupeve punuese të përkujdesjes



Institucioni ynë

Vizioni ynë

është të jemi shkollë udhëheqëse në Kosovë dhe rajon për arsimin profesional në fushat shëndetësore dhe sociale

Misioni ynë

është të implementojmë planprograme mësimore me mësimdhënës të kualifikuar dhe metodologji bashkëkohore e cila mundëson arritjen e standardeve evropiane për edukim të punëtorëve social dhe atyre shëndetësor duke i bërë ata konkurrues në tregun evropian.

Garantët e suksesit tuaj

Heimerer GmbH

- Me ndërmarrjet e tij Heimerer Schulen dhe Heimerer Akademie
- Rrjet të gjerë punëdhënësish në Gjermani
- Përvojë 30 vjeçare në fushën e arsimit profesional
- 11 qendra të Arsimit Profesional në Gjermani
- Mbi 500 mësimdhënës që aktualisht ofrojnë programe të certifikuar për më shumë se 2500 kandidat
- Kuotë punësimi direkt mbi 98%



Instituti i Evropës Juglindore për avancim në Shëndetësi dhe Infermieri

- Institucioni i vetëm shkencor në rajon i specializuar në këtë lëmi
- Specialist të spikatur të fushës
- Rrjet të gjerë bashkëpunimi në Evropë dhe rajon
- Referenca superiore ndërkombëtare dhe vendore



Kontakti/Adresa

Lagja Veternik, p.n.

Magjistralja Prishtinë-Gjilan

Orari: 09:00-16:00


Tel.: 038/555 099

038/555 098

Mob: 044/952 462

email: info@qeap-heimerer.eu

www.qeap-heimerer.eu



Arsim universitar shëndetësorë



të akredituara në
BE dhe Kosovë

Programe Master (MA) në Shëndetësi përmes përmes programit TEMPUS (BE)

■ **Menaxhimi I dhe Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore**

Në proces të Akreditimit

Programe Bachelor (BA) dhe (BSC)

■ **Logopedi**

Terapi e të folurit dhe gjuhës

■ **Ergoterapi**

Terapi fizikale përmes aktiviteteve punuese

■ **Infermiera e Përgjithshme**
■ **Pedagogjia Profesionale në Shëndetësi**

Fusha Profesionale Infermieri

Rruga evropiane e karrierës suaj profesionale

Logopedi

180 CP

Terapi e të folurit dhe gjuhës

Ky program i studimeve ju mundëson studentëve të bëhen ekspertë profesional për trajtim të çrregullimeve komplekse të komunikimit. Të diplomuarit në Logopedi aftësohen të trajtojnë të gjitha çrregullimet në komunikim dhe gëlltitje, tek fëmijët dhe të rriturit. Terapia logopedike është thellësisht e bazuar në evidencë shkencore dhe parime bio-mjekësore dhe përfshin diagnostifikimin, trajtimin dhe masat preventive.

Fushat e angazhimit

Logopedi i diplomuar i ofron shërbimet e tij në mjedise të ndryshme, siç janë: spitalet dhe klinikat, qendrat rehabilituese, objektet e kujdesit të specializuar, punëtoritë strehuese, çerdhe, shkollat, ndërmarrje dhe ordinanca private.

Synimet e programit të studimeve

- Të kuptuarit e komunikimit njerëzor dhe çrregullimeve në komunikim
- Zhvillimi i njohurive për të bërë dallimin në mes shoqërive, gjuhës dhe kulturës së individëve
- Integrimi i njohurive të fituara teorike dhe praktike si dhe shkathtësive profesionale në punën praktike me pacient.
- Vlerësimi, trajtim dhe menaxhim i problemeve të komunikimit dhe çrregullimeve të gëlltitjes
- Planifikim dhe zbatim i veprimeve terapeutike duke vendosur pacientin në qendër
- Të kuptuarit dhe zhvillimi i rolit të Logopedit ose terapeutëve të gjuhës dhe të folurit në sistemin shëndetësorë

Çdo program i studimeve zgjat 3 vite me gjithsej 6 semestra. Programet përbëhen nga kombinimi i ligjëratave teorike dhe ushtrimeve praktike. Studentëve ju ofrohet mundësia që një pjesë apo tërë praktikën ta përfundojnë në institucione të specializuara në Gjermani dhe vende tjera të Bashkimit Evropian së bashkuar. Struktura modulare e programit të studimeve mundëson fleksibilitetin dhe krijon kushte të përshtatshme për mobilitet të studentëve. Gjatë gjithë praktikës studentët do jenë të monitoruar nga një mentor profesionist.

Terapi fizikale përmes aktiviteteve punuese

180 CP

Ky program i studimeve iu mundëson studentëve të bëhen ekspertë profesional për trajtim terapeutik që mundëson funksionalizimin e aftësive për punë. Ergoterpia është një nga profesionet shëndetësore që ofron shërbime për individët e të gjitha moshave, tek të cilët funksionet fizike, mentale, sociale dhe kognitive janë dëmtuar. Trajtimi me ergoterapi lejon që të maksimizohet performanca e shkathtësive vepruese ditore tek klienti/pacienti në përditshmërinë jetësore. Kjo vlenë si për funksionet vepruese në punë ashtu edhe për ato në organizim e jetës private.

Fushat e angazhimit

Ergoterapeuti i diplomuar shërbimet e tij i ofron në një popullatë të gjerë në mjedise të ndryshme siç janë: spitalet dhe klinikat, qendrat rehabilituese, objektet e kujdesit afatgjatë, punëtori strehuese, shkolla, ndërmarrje dhe ordinanca private.

Synimet e programit të studimeve

- Të kuptuarit e veprimeve humane si pjesë e zhvillimit kryesor të njeriut, performancës dhe shëndetit
- Të kuptuarit e “disfunksioneve profesionale” (Pengesave në realizimin e veprimeve profesionale)
- Plani dhe zbatim i vlerësimit dhe trajtimit të disfunksionit të veprimeve.
- Integrimi i njohurive teorike dhe praktike si dhe aftësive rutinore në praktikë
- Mënjanimi i barrierave profesionale dhe avokimi në emër të klientit
- Të kuptuarit dhe zhvillimi i rolit të terapisë funksionale në sistemin shëndetësorë

Infermieria e Përgjithëshme

180 CP

Qëllimi i këtij programi është të kualifikoj studentë, të cilët do jenë në gjendje të veprojnë të pavarur, por edhe të marrin pjesë aktive në bashkëpunim ndër-disiplinor në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, në harmoni me zhvillimet shoqërore, shkencore dhe teknologjike.

Objektivat

Programi ka për bazë konceptin infermierorë që promovon dhe mirëmban shëndetin, bënë parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve, si dhe ofron shërbime rehabilituese dhe paliative për individin dhe grupin. Studentët me thirrjen akademike “Bachelor” në Infermieri, do të jenë në gjendje të ushtrojnë profesionin e infermierit konform kornizës së BE-së për infermieri në vend, rajon dhe Bashkësi Evropiane. Absolventëve ju mundëson vazhdimi i studimeve në nivelin Master.

Fushat e angazhimit

Infermierëve të diplomuar me titull Bachelor ju mundësohet të punësohen në këto hapësira profesionale:

- Ofrim i pavarur i shërbimeve profesionale të kujdesit infermieror në nivelin primar, sekondar dhe terciar në të gjitha institucionet shëndetësore.
- Udhëheqje dhe menaxhim të shërbimeve profesionale të kujdesit infermieror në nivelin primar, sekondar dhe terciar në të gjitha institucionet shëndetësore në nivelin e repartit apo institucionit.
- Menaxhim të rasteve/menaxhim të kujdesit
- Evidence-based Nurses (Monitorim të studentëve, realizim të projekteve të vogla hulumtuese)

